

# I. Legjenda e Rozafës në Vjenë<sup>II</sup>



**Skulptori kosovar që jeton dhe vepron në Vjenë të Austrisë, Destan Gashi, do të prezantohet para publikut vjenez me ekspositën personale 'Legjenda e Rozafës', me njëzet skulptura prej mermeri.**

**Alfred Beka**

alfred.beka@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 4 MARS –

Artdashësit vjenez e njojin prej vitesh, pasi edhe më herët ka hapur eksposita të ndryshme në kryeqytetin austriak por edhe në qytete tjera të Austrisë dhe të vendve të tjera evropiane. Skulpturat e tij kanë një tematikë që e lidhin me origjinën e tij. E tillë është edhe eksposita me titull 'Legjenda e Rozafës dhe histori të tjerë në guri' e skulptorit Destan Gashi, e cila do të hapet në Vjenë më 21 mars. Eksposita e Gashit do të hapet në galerinë Artefakt në Vjenë dhe do të qëndrojë e hapur deri më 11 prill. Në këtë eksposítë, skulptori Gashi trajton legjendat dhe traditat shqiptare, duke filluar nga legjenda e Rozafës, pastaj Doruntina, femrat hasjane e të tjera. "Eksposita prekëse e skulptorit Destan Gashi të rrëmben në një bote plot legjenda dhe mite. Gurët na tregojnë histori shqiptare, si ajo e legjendës së Rozafës, Doruntinës dhe hasjaneve, grave krenare të Malësisë së Hasit prej fshatrave pranë Drinit të Bardhë, të ndërgjegjishme për traditat e tyre", thuhet në informatën për eksposítën e Gashit.

Njëra prej skulpturave të tij, 'Legjenda e Rozafës', e përbërë nga mermeri, mishëron të por salindurin në gjirin e Rozafës.

Sipas legjendës, gruaja e re Rozafa u muros e gjallë në muret e kështjellës së Shkodrës në Shqipërinë e veriut, sepse, meqë ngrehina rrëzohej vazhdimi i gjatë ndërtimit, duhej të flijohet një njeri. Rozafa e pranoi fatin e saj, por dëshira e saj e fundit ishte që të mund t'i japë gjil të sapolin-durit edhe më pas, çka edhe iu pranua. Në mur u la një e çarë aq e madhe sa t'i jepite sisë foshnjës. Muret e ndërtueshë tanë qëndruan dhe kështjella mund të ndërtohet. Po ta vizitosh sot kështjellën e vjetër në periferi të Shkodrës, shikoni të rrjedhë mbi mure një lëng i bardhë që përbamb kalk. Thuhet që janë lotët dhe qumështi i Rozafës që derdhen që nga ato kohë të shkuara kur Rozafa u fut në mure. Duke i qëndruar besnik traditës së skulpturës në gur, Destan Gashi i kushtohet pothuaj me obcession temës së aktit femër. Në këtë ekspositë mund të shihen edhe mjafit skulpturë prej ciklit "Kokë vajzash" që janë krijuar vitet e fundit. Çdo skulpturë përfaqëson një individualitet të qartë që bazohet ndër të tjera edhe në vjetitë e vetë mermerit. Studime të gjata mbi natyrën dhe anatominë e lejojnë sot autorin që t'i skalit figurat direkt në gur pa pasur nevojë për model.

Në ekspositën që do të hapet në Vjenë fjallë e hajpes do ta mbajë profesori Johan Gunther, ndërsa të pranishëm pritet të jenë edhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Vjenë Vili Minarolli si dhe ai i Republikës së Kosovës Sabri Kiqmari.

Skulptori Destan Gashi ka përgjardhje nga Rahoveci. Ai ka diplomuar në Akademinë e Arteve të Bukura në Bruxsel, fillimisht në pikture më 1978 dhe më vonë ka vazduhar studimet në degën e skulpturës. Prej vitit 1987 jeton dhe krijon si skulptor i pavarur në Vjenë të Austrisë.

Prej vitit 1985, Gashi ka pasur shumë eksposita në galeri të ndryshme, nëpër kala, nëpër kopshtet dhe nëpër muze në Austri dhe në shitetë të tjera. Shumë vepra të tij gjenden nëpër koleksione private në Belgjike, Holandë, Itali, Austri, SHIBA, Spanjë dhe Gjermani.

Për skulpturat e tij, Gashi është nderuar me disa çmime, përfshirë çmimet "Prix d' Excellence de la Ville de Bruxelles", "Prix de Doutrelon de Try" dhe "Medaille de la ville de Bruxelles".